



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

KONSTATIME të Komitetit për Politikë dhe Financa, të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit të Komunës e caktuar të mbahet më 31 tetor 2023

Fillimisht, pas diskutimeve, njëzëri me 8 vota Për nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, mbështetet propozimi i anëtares së Kuvendit të Komunës dhe këtij Komiteti znj. Drita Pajaziti, për përfshirje në kuadër të rendit të ditës si pikë shtesë,

- **Marrja e vendimit për lirim nga taksa për mamografi.**

Me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), mbështetet propozimi i Ekzekutivit të Komunës, i paraqitur nga z. Vigan Salihu drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, për përfshirje në kuadër të rendit të ditës si pikë shtesë edhe,

- **Propozim vendimin për ngritjen e komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale – “Eko-Llapi” Sh.A.**

- **Propozim vendimi për formimin e komisionit ad-hoc për hartimin e Draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024**

Me 5 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim dhe shqyrtim kjo pikë e rendit të ditës sipas propozimit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

- **Propozim vendimi për vënien në konsultim publik Draft Planin Lokal i Veprimit për Barazi dhe Diskriminim në Komunën e Podujevës për periudhën 2023-2026**

Me 5 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim dhe shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës sipas propozimit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

- **Marrja e vendimit për lirim nga taksa për mamografi**

Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për përfshirje në kuadër të rendit të ditës për diskutim dhe shqyrtim të mundësive për lirim pa pagesë nga taksa komunale e kontroleve shëndetësore të mamografisë në QKMF – Podujevë.

- **Propozim vendimin për ngritjen e komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale – “Eko-Llapi” Sh.A.**

Me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të përmbajtur (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës rekomandohet për përfshirje në kuadër të rendit të ditës për diskutim dhe shqyrtim të kësaj pike sipas materialit të prezantuar në këtë mbledhje.

Nr. Prot.01-311/05-0078813/23
Podujevë, datë: 27 tetor 2023



Presuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d), 17 shkronja f) dhe 58 shkronja h), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr.03/L-087, Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, nenit 15 paragrafi 2.4, nenit 19 paragrafi 1.6 dhe nenin 61 paragrafi 1.8, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, sipas Vendimit nr.08/165 datë 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kryetari i Komunës, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i:

Propozon

VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE – “EKO-LLAPI” SH.A.

Neni 1

1. Kuvendit të Komunës i propozohet ngritja e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale – “Eko-Llapi” Sh.A. Podujevë, në përbërje si vijon:

_____, i/e emëruar nga Kuvendi i Komunës
_____, i/e emëruar nga Kuvendi i Komunës

2. Kryetari i Komunës me vendim të veçantë emëron një anëtar/e në kuadër të këtij Komisioni.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtareve të Komisionit janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, me plotësim ndryshimet e bëra me Ligjin nr.04/L-111 dhe Ligjin nr.05/L-009, Ligjit nr.02/L-016 për Shoqëritë Tregtare, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 02-020/04-0078715/23
Podujevë, datë: 26.10.2023

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 5 dhe 6 të Rregullores mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrja e Komunave në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Rregulloren Nr. 19/2015, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Ndërmarrja Publike Lokale "Eko-Llapi" Sh. A. Podujevë me 100% aksione nga Komuna e Podujevës.
2. Komuna e Podujevës autorizohet që të veprojë në emër të aksionarit të vetëm NPL "Eko-Llapi" Sh. A. dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e ligjshme duke përfshirë regjistrimin sipas Ligjit Nr.02/L-016 për Shoqëritë Tregtare.
3. Komuna e Podujevës, të drejtat e saj të aksionarit do t'i ushtrojë nga Komisioni Komunal i Aksionarëve, në emër të Komunës përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Komuna e Podujevës për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë